

PHONOSTYLISTIC, MORPHOSTYLISTIC AND LEXICOSTYLISTIC CHARACTERISTICS IN THE NOVELS OF ISMAIL KADARE

KARAKTERISTIKAT FONOSTILISTIKE, MORFOSTILISTIKE DHE LEKSIKOSTILISTIKE NË VERPAT E ISMAIL KADARESË

Hana DARDHISHTA¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: hana.dardhishta@unite.edu.mk

Abstract

In addition to being a writer, Ismail Kadare is also the central personality of Albanian culture in the second half of the 20th century. His name is associated with the *generation of the 1960s* in the literature, which brought a spirit of general emancipation to the national culture. Kadare's work, the novel "*The General of the Dead Army*", is the study material of this paper, including the novels "*The Concert*" and "*A Moonlit Night*". Kadare's literary activity is so abundant both in terms of titles and content. Kadare's novels that are based on history have the past as a trigger for the present, but even though we have selected some novels with such themes, the aim of this paper is the analysis of Kadare's language, especially the phonostylistic and morphostylistic characteristics in the abovementioned works of this great writer.

Similar to any other language, Albanian stylistics examines the Albanian language's instruments and expressive potential as well as its discourse structure, styles and texts from the perspective of secondary linguistic organization. Older words, neologisms, and regionalisms are examples of words with evocative power that can be employed as stylistic elements to give a text or style the right nuances, included phonetic organization—that is, combining words to create a perceptible expressive effect—sound symbolism, word formation as a stylistic element, and word-forming methods. In the elaborated part of the paper we have also the presentation or giving examples from Kadare's deeds.

Keywords: Kadare, lexicostylistic, phonostylistics, morphostylistics, word formation.

Përmbledhje

Ismail Kadare përveç që ishte shkrimtar, ai ishte dhe mbetet personaliteti qendror i kulturës shqiptare. Me emrin e tij lidhet ardhja në letërsi e brezit të viteve 1960, që solli një frymë emancipimi të përgjithshëm në kulturën kombëtare. Veprimtaria e Kadaresë është shumë e begatë si nga titujt ashtu edhe nga përmbajtja. Veprat e Kadaresë, romani "*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*", si edhe veprat "*Koncert në fund të vitit*" dhe "*Viti i mbrapshtë*" janë material studimi i këtij punimi. Romanet e Kadaresë që janë me temë nga historia, të shkuarën e kanë kryesisht si një shkas për të sotmen, por ne edhe pse i kemi përzgjedhur disa romane me tematikë të tillë, megjithatë synimi i këtij punimi është analiza e gjuhës së Kadaresë, sidomos karakteristikat leksikostilistike, fonostilistike dhe morfostilistike në veprat e lartëpërmendura të këtij shkrimtari të madh.

Sistemin e stileve e të ligjërimeve, mjetet e mundësitë shprehëse të shqipes dhe tekstet shqipe, të gjitha këto, nga pikëpamja e organizimit gjuhësor dytësor, i studion stilistika e gjuhës shqipe. Për stilistikën fjalët e vjetruara, neologjizmat, krahinorizmat janë fjalë që kanë një aftësi evokuese, që mund të shfrytëzohen si vlerë stilistike, kështu duke i dhënë ngjyrimin përkatës stilems ose tekstit, duke përfshirë organizimet fonetike (pra përbërësit tingullorë) që nëpërmjet ndërthurjes së fjalëve të bëhen të perceptueshme për efekt shprehës, simbolizmin tingullor gjithashtu edhe fjalformimin si element stilistik, si dhe identifikimin e mënyrave fjalëformuese. Në pjesën shtjelluese të punimit kemi edhe paraqitjen apo dhënien e shembujve nga veprat e Kadaresë.

Fjalët kyçe: Kadare, leksikostilistikë, fonostilistikë, morfostilistikë, fjalëformim.

Hyrje

Krijuesi, hera herës shpik një përmasë lirie për t'u arratisur dhe, një liri e tillë arratie është gjuha, më mirë thënë gjuha e veprës artistike. Ismail Kadare përveç se është një shkrimtar i përmasave botërore, ai është një shkrimtar thelbësisht shqiptar. Duke nisur nga thesari i pasur i gjuhës (përfshirë këtu edhe dialektet e shkrimeve të vjetra), historia shqiptare, kultura dhe miti, Kadare në romanet e tij, skalit Shqipërinë dhe letërsinë shqipe. Duke filluar që nga "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" që Kadare përfshin jetën e përditshme të Shqipërisë së atëhershme komuniste e me kujtime të historisë së Luftës së Dytë Botërore, pastaj për të vazhduar me veprën e tij "Kronikë në gur" me ngjarjet që ndodhin në qytetin e lindjes, Gjirokastra, e nëpërmjet disa veprave të tjera shkrimtari herë e dërgon lexuesin në malësinë e Shqipërisë me Kanunin e sidomos dukurinë e gjakmarrjes, e herë e dërgon lexuesin në Shqipërinë mesjetare, para pushtimit osman.

Veprat e Kadaresë i karakterizon një gjuhë shumë e pasur, gjithashtu edhe me krijimin e shumë fjalëve të reja dhe veshjen stilistike të tyre apo edhe duke u nisur nga elementet fjalëformuese të cilat automatikisht fjalës i japin një ngjyrim stilistik, për të vazhduar me krijimin e fjalëve të cilat janë stilema nga cildo pikëvështrim: fonetik, leksikor ose semantik. Në vijim të trajtimit të temës do të kuptojmë që analizën tonë e kemi përqëndruar rreth stilistikës së shprehësisë, që njëherit shqyrton mjetet dhe mënyrat shprehëse të gjuhës në disa nivele të saj, duke përfshirë: stilistikën e mjeteve fonetike, stilistikën e mjeteve morfologjike dhe stilistikën e leksikut.

Funksioni stilistik i gjuhës lind e zhvillohet si një kulturë gjuhësore dhe lidhet me përpunimin e shijes gjuhësore. Shtresat e ndryshme të fjalëve, përfshirë këtu: fjalët e vjetruara, neologjizmat, krahinorizmat kanë një aftësi evokuese që mund të shfrytëzohet si vlerë stilistike. Gjithashtu edhe spektri i vetive të tingujve të gjuhës si dhe ndërthurja e tyre, apo denduria fshehin mundësi për vlera shprehëse. Pra, stili është një veçanti e autorit, dhe për këtë mund të themi që Kadareja është një mjeshtër i vërtetë.

Trajtimi i çështjes

Qëllimi i përdorimit të elementeve stilistike ose përdorimet e stilemave të Kadareja i gjejmë më tepër për të ironizuar dhe përqeshur apo edhe për humor. Në analizën tonë në vijim do të rrekemi të japim edhe ngjyrimet subjektive të vetë fjalëve të cilat lindin nga marrëdhëniet vetjake të ligjëruesit me objektin e bashkëbiseduesin, nëse ka një të tillë. Shkrimtari apo autori nëpërmjet gjuhës së veprës me të cilën komunikon me lexuesin duke shprehur dëshirat, emocionet, vullnetin apo qëndrimet e tij, lë gjurmë në stilemat që përdor. Vendosija e normës ka bërë që disa variante të quhen krahinore, të vjetruara, të cilat mund të shfrytëzohen për qëllime shprehësie.

Pikërisht këto variante sjellin me vete ngjyime krahinore, sociale, kulturore etj. Analiza jonë do të përqëndrohet së pari tek karakteristikat fonostilistike duke përfshirë organizimet fonetike, për të vazhduar më tej tek karakteristikat morfostilistike duke përfshirë edhe ndajshitesimin. Parashtesat janë një nga elementet që autorët përdorin për krijimin e fjalëve, për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës, si dhe për qëllime stilistike. Në këtë model fjalëformimi hyjnë fjalët me parashtesën, ç-/sh-/zh- dhe fjalë të reja të Kadareja, i cili duke shtuar qoftë edhe një parashtesë mund të japë nuancë ngjyre, ndjenja, pamje etj. Gjithashtu kemi përfshirë edhe prapashtesimin si element stilistik dhe kompozimin stilistik. Për të vazhduar më tej edhe me karakteristikat leksikostilistike që përbëjnë shtresat e ndryshme të leksikut etj.

Karakteristikat fonostilistike

▪ Sa i përket karakteristikave fonostilistike mund të themi që tingujt janë ato që ndikojnë mbi ne, me ndërthurjet e tyre, pastaj me dendurinë e shpërndarjen e tyre që në njëfarë mënyre fshehin mundësi për vlera shprehëse, kështu duke marrë edhe vlera estetike dhe emotive. Në vijim do të sjellim disa karakteristika fonostilistike nëpërmjet shembujve të vjelë nga veprat e Kadaresë:

▪ Përbërësit tingullorë apo anët e sistemit tingullorë dalin në dukje te veprat e Kadaresë, kjo duke ndërthurur fjalët që të bëhen të perceptueshme për efekt shprehës. Kur na paraqiten organizime të tilla fonetike, të cilat na çojnë te një orkestrim tingullor i po atyre thënieve, që pastaj kthehet në tingëllim të afërt të gjymtyrëve të ndryshme. Këtë aspekt stilistik do ta tregojmë nëpërmjet shembullit në vijim: *S'dimë gjë, thanë zëra, na trego si është puna Kus Baba, dhe ai na tregoi se n'atë kartë apo mehmurmandum apo dreqi e di si quhej, i kishin shkruar mbretit Vid, ne pranojmë...* (Kadare, VM, 1990: f. 53). Pra, siç shikojmë në vend të fjalës memorandum kemi mehmurmandum që në tekst na vjen me ngjyrim kulturor.

▪ Në veprat e Kadaresë edhe ngjyrimet krahinore e sociale nuk mungojnë. Ndjenja gjuhësore kërkon kudo një kuptim. Tingujt e veçuar edhe pse nuk bartin kuptim, hera herës për arsye të ndryshme, kur vendosen lidhje ndërmjet tingullit e kuptimit, atëherë kemi të bëjmë me burim shprehësie. si p. sh., dhëmboret e grykoret përdoren për të treguar trokitjet, si: *dam-dum, dum-dum, tang-tang*, si shembujt në vijim: *Prita mesin e natës, numërova dam-dumet e orës, mbaroi...*, (Kadare, VM, 1990: f. 65); *I ngjashëm me dum-dumin molisës të daulles duhej të ishte gjumi...* (Kadare, VM, 1990: f. 26); *Tang, tang, tang... Tingulli i orës së qytetit më bën që ta tërheq dorën.* (Kadare, VM, 1990: f. 64).

▪ Gjithashtu bashkëtingëlloret dridhëse përdoren për të treguar dridhjet, si: *brr*, p. sh. «*Brr, sa ftohtë!* » - *tha ajo me vete dhe e kuptoi se pikërisht e ftohta ishte që e kishte zgjuar.* (Kadare, KFD, 1990: f. 17). Madje ka edhe fjalë të tilla, të cilave nuk ua dimë kuptimin, por nga tingullimitimi na ngjallin një përshtypje, kuptim ose ndjenjë me tingëllimin e tyre, si: *gëk, mëk* (Kadare, VM, 1990: f. 52), p. sh. *U mbështet në shilten e madhe, e kuptuan të gjithë që do të këndonte vetë, as gëk as mëk s'bënte kush...* (Kadare, VM, 1990: f. 52).

▪ Kemi raste kur për të riprodhuar të njëjtin tingull, zë, zhurmë, britmë, klithmë etj. të një sendi apo dukurie të dhënë, përdoren, në mjaft raste, tingullimitime me përbërje të ndryshme tingullore, si në shembujt në vijim: *ciu-ciu, firifiu, fyryfyçkë* etj. *Po t'i kishin trutë në vend, ndryshe nga prishja me sovjetikët, kur u gëzuan se u lindën ca shpresa, tani duhej të dëshpëroheshin, mirëpo koka e tyre është bërë tani firifiu, nuk e shikon si qeshin?* (Kadare, KFD, 1990: f. 149); *Kishte mbyllur sytë ndaj çdo rrezikimi të mundshëm me një vetësiguri prej fyryfyçke.* (Kadare, KFD, 1990: f. 152). Për të vazhduar më tej me shembujt si në vijim: *kukuku e kakaka, pllaraq-plluq, shkrap-shkrup* etj., p. sh.: *Plasi gaz i madh kukuku e kakaka po Kus Babaj tha, ashtu duket, për të qeshur, veç po pranoi mbreti këtë do të...* (Kadare, VM, 1990: f. 53, 50, 49); *Pastaj ramë në baltovinën e Kallamasë, pllaraq-plluq, edhe ..., lluca ia zuri me sa dukej frymën u pllaurit sa u pllaurit një copë herë, pastaj s'u ndie më.* (Kadare, VM, 1990: f. 50); *...pale kur bënin sikur flisnin hollandisht tek ai hani me atë emër të ndytë pushtësh, shkrap-shkrup, ç'u vinte në kokë...* (Kadare, VM, 1990: f. 49) etj.

▪ Po kështu ndodh edhe me tingullin *c*, i cili për shqiptarët jep përshtypjen e zvogëlimit, si: *dhëmbec, picërruar, vockël* etj., p. sh. (picërruar) *E la trupin e Cute Bënjës që po ftohej dhe me sy të picërruar vështroi në drejtim të hanit.* (Kadare, VM, 1990: f. 44); (vockël) *Nga banesa e tij fare e vockël, konsulli rus e shihte rrugën...* (Kadare, VM, 1990: f. 71) etj.

Kështu kuptojmë që ndjenja gjuhësore kërkon një kuptim, kudo edhe në një tingull.

Karakteristikat morfostilistike

▪ Parashtesimi si element stilistik. Në këtë model fjalëformimi hyjnë fjalët me parashtesën, ç-/sh-/zh- të cilën e gjejmë te Kadareja, i cili duke shtuar qoftë edhe një parashtesë, mund të japë nuanca ngjyre, pamje, ndjenjë, si p. sh. *çgrarizohen, çjetëzohej, çnjerëzi* etj. (Kadare, KFD, 1990: f. 103, 111, 310); *shfiguruar, shplekseshin, zh dramatizoj*. (Kadare, VM, 1990: f. 71, 25, 75)

▪ Prapashtesimi si element stilistik. E veçanta e krijimive të reja me prapashtesat zvogëluese -ëz, -th është fakti se Kadareja me anë të këtij lloj prapashtesimi ka krijuar vërtet fjalë me kuptime konkrete, me kuptime zvogëlimi, si p. sh.: *çikëz, dredhkëz(at), dritarëz(at), lojëz, peliçëz, shpresëz, togëz(at)* (Kadare, KFD, 1990: f. 41, 285, 106, 301, 284, 145, 106); *mollëz(at)* (Kadare, GJUV, 1990: f. 22); *copëz, dritëz, dhëmbëz, flakëz, pakëz, rrotëz* (Kadare, VM, 1990, f. 43, 69, 39, 64, 11, 39). Krijimet me prapashtesën -th te Kadareja na paraqiten në shumë raste, si p. sh.: *globth, sekretth(e), shtetth(e)* (Kadare, KFD, 1990: f. 105, 93, 37); *pëllumbth, shtetth, zjarrth(e)* (Kadare, VM, 1990: f. 71, 73, 40) dhe nuk mund të mos shihen si krijime me funksione artistike. Ka emra të tillë të rinj si *shtetth* ose *globth* të formuara po me këtë prapashtesë, që njëkohësisht është prapashtesë që shpreh kuptime zvogëlimi, që në këtë rast Kadareja nëpërmjet kësaj prapashtese fjalëve u vesh petkun e ironisë.

▪ Në fushë të stilistikës nuk mund të mos e përmendim përdorimin e gjerë të emrave prejfoljorë me prapashtesën -im. E veçanta është kuptimi i ri që marrin, si: *ardhurim, dancim, ngazëllim, pickim, rënkim, shoqërim* etj. (Kadare, KFD, 1990: f. 95, 316, 204, 48, 99, 195).

▪ Trajtat e shumësit të emrave në gjuhën shqipe, e dimë, që kanë larmi të madhe. Zakonisht njëra trajtë vendoset si më normative dhe asnjane, të tjerat marrin ngjyrimet përçmuese e ironike. Shumë emra, tashmë mund të ndërtojnë një shumës me prapashtesën -ra, pikërisht duke marrë ngjyrim shpërfillës, si p. sh.: *baltra, ceremonira, copëra, fantazira, historira, kafenera, kancelarira, llogarira, mbrapshtira, ministrira, qeverira, vogëlsira, zbrazësira* etj. (Kadare, KFD, 1990: f. 306, 72, 157, 288, 162, 35, 331, 288, 176, 136, 301, 70, 310); *fatkeqësira, shakara* (Kadare, GJUV, 1990: f. 68, 65); *akullsira, hatara, hiler, tapira, tregtira* (Kadare, VM, 1990: f. 78, 52, 18, 19, 19).

▪ Një përftesë tjetër tek e cila përzihen më shumë elemente stilistike na del prapashtesa -shëm, e përdorur aq dendur nga Kadareja për të krijuar jo vetëm mbiemra të nyjshëm, por edhe një numër të madh ndajfoljesh. Pra, si vlerë stilistike llogariten edhe ndajfoljet me prapashtesën -shëm. Ato janë të zakonshme në dialektin e gegërishtes. Të tillë shembuj kemi hasur edhe te veprat e Kadaresë që i kemi si lëndë për analizën tonë, si p. sh. *besueshëm, çuditshëm, dëmshëm, gëzueshëm, lemerishëm, lodhshëm, mendueshëm, mundshëm, ngutshëm, papërfillshëm, përhumshëm, rrëshqitshëm, rrufeshëm, skëterrshëm, shkujdesshëm, vëmendshëm, vrullshëm* etj. (Kadare, KFD, 1990: f. 107, 107, 99, 124, 300, 28, 151, 152, 136, 91, 307, 263, 205, 211, 48, 178, 178); *humshëm, kumbueshëm, mistershëm, mynxyrshëm, ndritshëm, ngadalshëm, ngashëryeshëm, pikëllueshëm, shkretueshëm, shtrëngueshëm, trembshëm, thirravajshëm, virtutshëm* etj. (Kadare, VM, 1990: f. 63, 10, 99, 57, 75, 8, 79, 35, 101, 39, 64, 107, 34). Ndajfolja *pikëllueshëm*, në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe nuk del si mbiemër, por është mbiemri i nyjshëm 'i pikëlluar'. Pra, vjen prej pjesores geqe që kryesisht shërben për ndërtimin e mbiemrave të këtij tipi. Megjithatë, sistemi i gjuhës shqipe nuk e përjashton ndërtimin e një mbiemri, prej të cilit, me konversion përftohet ndajfolja. Edhe ndajfolja *përhumshëm*, në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe nuk del si e tillë, por del vetëm si mbiemër (*i, e*) *përhumur*. Këto krijime ndajfoljore (e që janë të shumta në veprat e Kadaresë) janë nuancë kryesore dhe element kryesor stilistik i Kadaresë.

▪ Në disa raste mjaft efekt na bën edhe shumësi i emrave, ndonëse sipas normës jepen si të barasvlershme disa trajta të shumësit për të njëjtën fjalë, ka dallime të ndjeshme stilistike, p. sh. *yjtë* është trajtë e vjetër, si te shembulli në vijim: *...thua se në çastin e fundit donte të shihte me to vrasësin, por nga larg, si nga yjtë...* (Kadare, VM, 1990: f. 45).

▪ Sa i përket përemrave mund të themi që ato edhe pse nuk kanë larmi të trajtave, megjithatë janë të pranishme variantet krahinore apo dialektore, si p. sh.: *asish, syresh* etj., p. sh. *Të bindur se raca e shkrimtarëve që zhdukur nga bota, tani që pëshpërtej se dy prej asish fantazmash vërtiteshin nëpër Kinë, ata provonin një...* (Kadare, KFD, 1990: f. 306).

Kompozimi stilistik

Kompozitat e Kadaresë janë shtylla tjetër kryesore e fjalëkrijimit të tij. E veçanta e Ismail Kadaresë mbetet pikërisht në fushën e fjalëve, që ka të bëjë me "brumin gjuhësor" që zgjedh me kujdesin më të madh dhe e përdor aty ku duhet duke e përshtatur me hapësirat prej nga vijnë prurjet leksikore dhe mjetet fjalëformuese. Pra, kur vjen fjala për kompozitat e Kadaresë, ato janë të shumta dhe njëkohësisht të begatshme.

▪ Disa prej tyre janë krijime me ngjyime therëse, që mbërthejnë një ironi brenda vetes, si p. sh.: *ëndërradiellsa, këshillurdhër, ngazëllimotmerr* etj. (Kadare, KFD, 1990: f. 38, 259, 253); *buçkarashe, turravrap* etj. (Kadare, VM, 1990: f. 9, 6). Në gjuhën shqipe, siç e dimë bashkimi i temave në një fjalë të vetme të përbërë (kur kemi të bëjmë me kompozitë me marrëdhënie bashkërenditëse apo këpujore), rregullisht bëhet pa ndërmjetësimin e zanoreve lidhëse o/a. Kompozitat me zanore lidhëse janë shumë të pakta, por që funksionojnë në gjuhën shqipe dhe siç po shohim ato po shtohen. Duke vazhduar me analizën tonë rreth këtyre veprave, në vijim do të japim pikërisht këto shembuj me ndërmjetësimin e zanoreve lidhëse, si: *ngazëllimotmerr, turravrap* etj., p. sh.: *A partinë? Pyeste ministri duke u rrëqethur prapë nga ai ngazëllimotmerr i panjohur.* (Kadare, KFD, 1990: f. 253); *Ata vraponin me ulërimë nëpër kufirin shqiptaro-malazes, futeshin në zonën veriore të shtetit shqiptar, dilnin nga pjesa e tij lindore, për t'u sulur turravrap drejt kufirit greko-maqedonas.* (Kadare, VM, 1990: f. 6)

▪ Ka edhe kompozita të tilla që japin kuptime abstrakte, të pakapshme, edhe pse pjesët përbërëse të tyre mund të jenë edhe emra të zakonshëm, si: *gjysmëkëpuçë, gjysmëndërr, gjysmëpapuçe, katërfshatars, shtatëfshatars, trifshatars(in)* etj. (Kadare, KFD, 1990: f. 90, 21, 318, 317); *njëshkolonës* etj. (Kadare, VM, 1990: f. 30); p. sh.: *Dje në komunën «Miqësia shqiptare-kineze», patëm një takim me Trifshatarsin, emër vërtetë i çuditshëm ky...* (Kadare, KFD, 1990: f. 317); - *E keni fjalën për Katërfshatars apo ndoshta Shtatëfshatars? – pyeta. – E si do të jenë ata?* (Kadare, KFD, 1990: f. 318).

▪ Studiuues të ndryshëm të cilët i janë përkushtuar studimit të veprës së Ismail Kadaresë, në mënyrën më të thelluar, pasi kanë qëmtuar e vëzhguar për kohë të gjatë edhe fjalësin e veprave të Kadaresë, kanë arritur në përfundim se në prozën e tij ka shumë fjalë dhe forma apo kuptime fjalësh, shumica e të cilave nuk gjenden në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe. Çdo lexues i veprave të Kadaresë gjithashtu do të vijë në një përfundim të tillë. Në vijim do të japim disa sosh nga ato fjalë që nuk janë në fjalor, të cilat i kemi evidentuar gjatë analizës së këtyre veprave, si: *bashkëkomplotistët, ëndërradiellsa, darkëtarët, fтомën, gjysmëdremitje, gjysmëkëpuçë, gjysmëndërr, gjysmëpapuçe, gjysmëterr, hënëzbardhur, katërfshatars, këshillurdhër, kryekurtëve, kushedisatën, lavapjatë, marroke, matufeps, miqësiprishës, natar, ngazëllimotmerr, shtatëfshatars, terakotë, trifshatarsin, trirrotëshe, zymtajë(n)* etj. (Kadare, KFD, 1990: f. 114, 38, 28, 21, 155, 27, 90, 21, 90, 121, 27, 318, 259, 143, 22, 132, 38, 40, 3, 253, 318, 8, 317, 3, 170); *kuplartë* (Kadare, GJUV, 1990: f. 62); *buçkarashe, njëshkolonës, triharkëshe, zogarja* etj. (Kadare, VM, 1990: f. 9, 30, 48, 6); p. sh.: *Dhe në të gjitha herët ishte çanta që e pengonte të hynte dhe të zinte vend midis darkëtarëve.* (Kadare, KFD, 1990: f. 314)

Karakteristikat leksikostilistike

E pamundur është të mos përfshihet edhe leksikostilistika në këtë punim. Gjatë leximit dhe analizës së veprave të Kadaresë kuptojmë se leksiku përmban fjalë të vjetruara, neologjizma, krahinorizma, dhe të gjitha këto përbëjnë shtresat e ndryshme të fjalëve dhe për

stilistikën kjo do të thotë se kanë aftësi evokuese dhe njëkohësisht të shfrytëzohen si vlerë stilistike. Vetitë leksikore që shërbejnë si vlera stilistike i japin ngjyrimin përkatës tekstit.

- Marrëdhëniet e gjuhës letrare me dialektet kanë një rrugë historike, kështuqë dialektalizmat janë mjete me prejardhje dialektore, që përfshihen në një tekst për qëllime stilistike (sepse mund të ndryshojnë nga ana fonetike, morfologjike, fjalëformuese, kuptimore etj. Kadareja është ai shkrimtar që veprat e tij çdo herë i ka pasuruar me fjalë e shprehje të dialektit verior, si p. sh.: *grahte (makinën)*, *i mençmi*, *trandte* etj. (Kadare, KFD, 1990: f. 204, 292, 300); *yjtë*, *avit* etj. (Kadare, VM, 1990: f. 45, 49)

- Arkaizmat, gjithashtu si fjalë të dikurshme që tashmë janë vjetruar ose po vjetrohen dhe për këtë arsye kanë dalë ose po dalin nga përdorimi, si p. sh. *hijezë* për ombrellë ose *lëçitje* për veçim.²⁸

- Historizmat, që janë përdorur në një periudhë të caktuar kohe dhe sot i hasim kryesisht në letërsi ose në veprat shkencore që flasin për atë periudhë, si: *padishah*, (Kadare, VM, 1990: f. 84); apo *mareshali* (që sot nuk dëgjohet shumë, përveç se në disa ushtri që kanë grada, pra si gradë më e lartë në hierarkinë ushtarake) etj., p. sh.: *Fjalët «Ku po shkojmë?» gjithashtu janë shqiptuar por jo në veturën e mareshalit dhe as prej tij.* (Kadare, KFD, 1990: f. 443)

- Një shtresë e gjerë e fjalëve të vjetruara rrojnë më gjatë në ligjërimin bisedor, sidomos kjo për orientalizmat apo më mirë thënë turqizmat. Kjo shtresë fjalësh hera-herës shërben për humor e ironi, si p. sh. *aferim*, *edepsëz*, *haber*, *jarebi*, *muhabet* etj. (Kadare, VM, 1990: f. 55, 54, 84, 83); *begenis*, *meazallah* (Kadare, KFD, 1990: f. 237, 284).

- Vend të veçantë në veprat e Kadaresë zënë edhe fjalët e quajtura huazime orientale, për arsyen se po këto fjalë kanë ardhur nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me turqishten (gjithashtu ka përcjellë praninë e shtresave të ndryshme orientale në gjuhën shqipe, duke patur parasysh që populli ka qenë në kontakt me kulturën orientale, dhe prej kësaj vijnë fjalë që i përkasin leksikut përkatës të fushave të ndryshme, si në veshje, orendi, zakone, gatime, kulturë etj.), si: *abansëz* (Kadare, KFD, 1990: f. 192); *hajat*, *hargalis*, *jabanxhinj*, *kumarhane*, *mejhane*, *mysafirhane*, *ruspije*, *sikter*, *shilte*, *qafir* etj. (Kadare, VM, 1990: f. 55, 83, 84, 52, 52, 51, 83, 54, 52, 84), p. sh.: *...na prano baba, mos na sikteris dhe na dërgo haber si të bëjmë që t'i grijmë jabanxhinjtë, qafirët dhe të ...* (Kadare, VM, 1990: f. 84). Në veprat e Kadaresë hasen edhe turqizma të tjera, por këto fjalë i përmban edhe FGJSSH, që do të thotë se një kohë të gjatë kanë gjetur përdorim në popull dhe që tani koha po e dëshmon se këto fjalë po përdoren shumë rrallë, pothuajse fare, meqë janë zëvendësuar me fjalë të tjera shqipe, si: *begenis*, *harlis*, *meazallah*, *meskin* (Kadare, KFD, 1990: f. 237, 73, 284, 81); *çibuk*, *xhade*, *xham* etj. (Kadare, GJUV, 1990: f. 13, 17, 59)

- Karakteristikë tjetër janë edhe prapashtesat me prejardhje orientale, sidomos: -llëk, -lli, -xhi, p. sh.: *fshatarllëk(ut)* (Kadare, KFD, 1990: f. 317); *kaurllëk*, *kurvellëk* (Kadare, VM, 1990: f. 54), gjejmë edhe fjalë të tjera po me këtë prapashtesë, por janë fjalë të cilat i përmban edhe FGJSSH, pastaj kemi shembujt si: *boshllëk*, *spiunllëk dhe synetllëk* (Kadare, VM, 1990: f. 96, 32, 62); -lli: *synetlli* (Kadare, VM, 1990: f. 53) dhe -xhi: *interesaxhi* (Kadare, KFD, 1990: f. 205); *kafexhi* etj. (Kadare, GJUV, 1990: f. 57).

Përfundimi

Gjuha te këto vepra të Kadaresë nuk është vetëm mjet, por edhe një mëtim apo zotim i tij parësor, ndaj të cilit në çdo faqe e rresht të prozës së tij lë një përkushtim të thellë, duke i dhuruar gjuhës sonë një tufë të madhe fjalësh të veçanta, Kadareja tërthorazi tregon besimin dhe bindjen se shqipja është një gjuhë e gjallë, e cila, ndonëse jeton në këto kohë dinamike dhe njëkohësisht të rrezikshme, vazhdon të mbetet gjuha që u bëri ballë sundimeve të gjuhëve të

²⁸ Dy shembuj të cit. nga <https://scholar.google.com/> Hana Dardhishta, *Stylistics of phonetic and morphological tools in Kadare's works*, International Journal of Albanology, University of Tetova, 2024: f. 140-146

tjera të ndryshme në kohërat e mëparshme, varësisht nga sunduesi. Ismail Kadareja ishte dhe mbetet një fjalëkrijues gjithmonë i veçantë, i etur për prurje të reja të fjalës, por gjithmonë nga brumi i gjuhës shqipe. Ai gjithashtu na paraqitet si një shoshitës i paepur i leksikut të shqipes, na paraqitet si mbledhës dhe grumbullues i fjalëve të ndryshme prej trevave të ndryshme shqiptare, por edhe përpunoi e rikrijoi pa u ndalur, si fjalë, terma e mënyra të thëni që nuk i kishte më parë as gjuha e folur letrare, as letërsia para tij.

Nga shembujt e mësipërm, pamë që organizimet fonetike çojnë te një orkestrim tingullor i thënieve, që kthehet në paronomazi, edhe shoqërimet tingull – kuptim në veprat e Kadaresë, gjithashtu janë prezente, të vendosura qëllimisht për të arritur efekte të ndryshme dhe kjo po që është një burim shprehësie. Përdorimet e stilemave apo më mirë thënë përdorimin e elementeve stilistike të Kadareja e gjejmë herë për të ironizuar e herë për të përqeshur, e në disa raste edhe për ngjyrimë emocionale, por mbi të gjitha qëllimi i përdorimit të këtyre elementeve është gjuhëpastrimi dhe gjuhëpasurimi.

Shkurtesat

GJUV - *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*

KFD - *Koncert në fund të dimrit*

VM - *Viti i mbrapshtë*

Referencat

- [1]. Dhrimo, Ali, *Mbiemrat në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2017.
- [2]. *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.
- [3]. Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 1995.
- [4]. Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
- [5]. Kadare, Ismail, *Koncert në fund të dimrit*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
- [6]. Kadare, Ismail, *Viti i mbrapshtë*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
- [7]. Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001.
- [8]. Lloshi, Xhevat, *Vështrime stilistike*, Tiranë, 2021.
- [9]. Memisha, Valter, *Studime për fjalën shqipe II*, Tiranë, 2015.
- [10]. Thomaj, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974.
- [11]. Thomaj, Jani, *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.
- [12]. <https://scholar.google.com/> *Stilistika e mjeteve fonetike dhe morfologjike në veprat e Kadaresë (Stylistics of phonetic and morphological tools in Kadare's works)*, H. Dardhishta, ALBANOLOGJIA International Journal of Albanology 11 (21-22), p. 140-146.